# FLETORJA ZYRTARE

## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2022 – Numri: 161

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E hënë, 5 dhjetor 2022**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 1.12.2022 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar.................................................... | 19053 |



Adresa: Rruga "Nikolla Jorga", Tiranë: Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

**AKT NORMATIV**
**Nr. 17, datë 1.12.2022**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 115/2021, "PËR BUXHETIN E VITIT 2022", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni l

Nenet 1, 2, 3, 4 , 5 dhe 6 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"Neni 1

Buxheti për vitin 2022 është:

| | |
|---|---|
| Të ardhurat | 581 831 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 665 694 milionë lekë; |
| Deficiti | 83 863 milionë lekë. |

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2022 është:

| | |
|---|---|
| Të ardhurat | 434 644 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 518 507 milionë lekë; |
| Deficiti | 83 863 milionë lekë. |

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2022 është:

| | |
|---|---|
| Të ardhurat nga të cilat: | 61 460 milionë lekë, |
| - transferta e pakushtëzuar e përgjithshme | 18 733 milionë lekë; |
| - transferta e pakushtëzuar sektoriale | 9 353 milionë lekë; |
| - transferta specifike | 1 165 milionë lekë; |
| - të ardhura të tjera | 32 209 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 61 460 milionë lekë. |

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2022 është:

l. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

| | |
|---|---|
| Të ardhurat gjithsej nga të cilat: | 147 203 milionë lekë, |
| - kontributet | 100 629 milionë lekë; |
| - transferimet nga buxheti i shtetit | 39 974 milionë lekë; |
| - transferta për indeksimin e pensioneve | 3 100 milionë lekë; |
| - bonusi i pensionistëve | 3 500 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 147 203 milionë lekë. |

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për kategoritë e veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2022, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar.

| | |
|---|---|
| Të ardhurat gjithsej nga të cilat: | 7 732 milionë lekë, |
| - kontributet | 1 896 milionë lekë; |
| - transferimet nga buxheti i shtetit | 5 636 milionë lekë; |
| - transferta për indeksimin e pensioneve | 200 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 7 732 milionë lekë. |

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 3 300 milionë lekë.

Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 950 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në përpjesëtim me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2022 është:

| | |
|---|---|
| Të ardhurat gjithsej | 52 836 milionë lekë, |
| nga të cilat: | |
| - kontributet dhe të tjera | 16 030 milionë lekë; |
| - transferimet nga buxheti i shtetit | 36 806 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 52 836 milionë lekë. |

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11 800 milionë lekësh, përfshirë detyrimet e prapambetura dhe rimbursimin e medikamenteve për kurimin e COVID-19. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2022 është:

| | |
|---|---|
| Të ardhurat gjithsej | 3 500 milionë lekë |
| nga të cilat: | |
| - të ardhura të tjera | 1 000 milionë lekë; |
| - transferimet nga buxheti i shtetit | 2 500 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 3 500 milionë lekë.". |

**Neni 2**

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

1. Shifra "... 20 000 milionë lekësh..." zëvendësohet me "... 32 400 milionë lekësh ...".

2. Në fund të nenit shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:

"Në varësi të ecurisë së projekteve të rindërtimit, ministri përgjegjës për financat rialokon fondet, të cilat janë ngurtësuar nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave.".

**Neni 3**

Nenet 9 dhe 10 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

| | |
|---|---|
| Grantet | 11 994 milionë lekë; |
| Të ardhurat tatimore | 398 000 milionë lekë; |
| Të ardhurat jotatimore | 24 650 milionë lekë. |

Neni 10

Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër se deficiti i përcaktuar në nenin 1, të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të brendshme deri në kufirin maksimal prej 33 000 milionë lekësh.

Pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja është rreth - 4 225 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikative si më poshtë vijon:

- Huamarrje afatgjata të destinuara për projekte me vlerë rreth 15 202 milionë lekë;
- Huamarrje në formën "mbështetje buxhetore" nga institucione financiare ndërkombëtare, me vlerë rreth 18 987 milionë lekë;
- Ripagesa të principalit, me vlerë rreth - 39 042 milionë lekë;
- Nënhua për pushtetin vendor, me vlerë rreth 627 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë është rreth 55 088 milionë lekë.

Çdo diferencë, që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme të përmendura në këtë nen dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice, akumulohet në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën

e Shqipërisë ose, në rast mungese, përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2022, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila automatikisht rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2, të këtij ligji.”.

Neni 4

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

| | |
|---|---|
| - shpenzime të buxhetit qendror | 499 987 milionë lekë; |
| - fondi rezervë i buxhetit | 3 500 milionë lekë; |
| - kontingjencë për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës | 10 220 milionë lekë; |
| - kontingjencë për risqet e borxhit | 4 800 milionë lekë.”. |

2. Në paragrafin 7, shuma “...1 900 milionë ...” zëvendësohet me “...1 200 milionë ...”.

3. Paragrafi i tetë për fondin e shpronësimeve shfuqizohet.

4. Paragrafët e nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Fondi prej 360 milionë lekësh, i parashikuar në programin buxhetor “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përdoret për parafinancimin, bashkëfinancimin dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të detyrimeve doganore për projektet me financim të huaj. Procedurat e shpërndarjes së këtij fondi përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e shpenzimeve të përcaktuara në nenin 3, si dhe në tabelat 1 dhe 3, që përmenden respektivisht në nenet 11 dhe 15 të këtij ligji.

Fondi prej 20 000 milionë lekësh për mbështetjen e sektorit energjetik përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për financat. Fondi i kontingjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, prej 10 220 milionë lekësh, përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave.

Për përballimin e efekteve, që burojnë nga zbatimi i aktit normativ nr. 10, datë 18.5.2022, “Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022”, ministritë/institucionet përgjegjëse përdorin fondet brenda tavanit buxhetor të miratuar për çdo institucion.”.

5. Në fund të nenit shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Gjendja e mjeteve monetare, që do të rezultojë në fund të vitit buxhetor 2022 në llogarinë unike të thesarit, si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve ose tejkalimit të të ardhurave, transferohet në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë, në masën jo më shume se 11 000 milionë lekë dhe përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave.”.

6. Tabelat 1 dhe 4, që përmenden në këtë nen, zëvendësohen me tabelat 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 5

Në nenin 14, shifra e fondit rezervë ndryshohet dhe bëhet “... 3 500 milionë lekë ...”.

Neni 6

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e gjashtë, në fjalinë e fundit, shifra bëhet “... 500 milionë lekë ...” dhe pas fjalisë së dytë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me miratimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rishpërndan këtë fond ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas nevojave dhe rasteve të situatës emergjente.”.

2. Në fund të nenit shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Shuma 1 000 milionë lekë si transfertë specifike shpërndahet sipas bashkive dhe qarqeve, duke marrë si kriter peshën e detyrimeve të secilës njësi të vetëqeverisjes vendore ndaj totalit të detyrimeve të prapambetura të muajit dhjetor 2021, si dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për

çdo njësi të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2018-2021. Ky fond përdoret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, sipas rregullave që përcaktohen nga ministri përgjegjës për financat, duke i dhënë përparësi detyrimit më të vjetër.".

3. Tabela nr. 3, që përmendet në këtë nen, zëvendësohet me tabelën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 7

Neni 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese për vitin 2022, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 42 548 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj, deri në 28 775 milionë lekë;

- Për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese deri në 13 774 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 425 860 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 356 540 milionë lekë;

- Stoku i borxhit të garantuar nga qeverisja qendrore 68 670 milionë lekë;

- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 650 milionë lekë.".

**Neni 8**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## BUXHETI 2022
## SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Tab.1

| Kodi | Emërtimi i institucionit/programit | Totali i shp. Korrente | Shpenzimet kapitale: Financim i brendshëm | Shpenzimet kapitale: Financimi i huaj | Shpenzimet kapitale: Totali i shp. kapitale | Totali i shpenzimeve buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **Presidenca** | **227,778** | **16,000** | **0** | **16,000** | **243,778** |
| 01120 | Veprimtaria e Presidentit | 227,778 | 16,000 | 0 | 16,000 | 243,778 |
| **2** | **Kuvendi** | **1,006,244** | **192,200** | **0** | **192,200** | **1,198,444** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 373,961 | 192,200 | 0 | 192,200 | 566,161 |
| 01120 | Veprimtaria ligjvënëse | 632,283 | 0 | 0 | 0 | 632,283 |
| **3** | **Kryeministria** | **458,050** | **13,500** | **0** | **13,500** | **471,550** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 458,050 | 13,500 | 0 | 13,500 | 471,550 |
| **5** | **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** | **6,868,510** | **2,518,264** | **2,572,251** | **5,090,515** | **11,959,025** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 333,354 | 4,500 | 0 | 4,500 | 337,854 |
| 04220 | Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit | 1,424,431 | 89,359 | 198,014 | 287,373 | 1,711,804 |
| 04240 | Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes | 671,340 | 1,168,911 | 0 | 1,168,911 | 1,840,251 |
| 04250 | Zhvillimi Rural duke mbësht. prodh. bujq, blek., agroind. dhe market. | 3,846,725 | 945,844 | 2,325,755 | 3,271,599 | 7,118,324 |
| 04860 | Këshillimi dhe informacioni bujqësor | 440,850 | 170,000 | 0 | 170,000 | 610,850 |
| 05470 | Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore | 18,000 | 0 | 0 | 0 | 18,000 |
| 04230 | Mbështetje për Peshkimin | 133,810 | 139,650 | 48,482 | 188,132 | 321,942 |
| **6** | **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** | **7,803,231** | **31,886,239** | **10,611,755** | **42,497,994** | **50,301,225** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 463,050 | 10,825 | 0 | 10,825 | 473,875 |
| 04520 | Transporti rrugor | 3,385,375 | 20,571,887 | 4,580,132 | 25,152,019 | 28,537,394 |
| 04540 | Transporti detar | 99,435 | 35,000 | 8,000 | 43,000 | 142,435 |
| 04550 | Transporti hekurudhor | 515,853 | 400,000 | 1,695,349 | 2,095,349 | 2,611,202 |
| 04560 | Transporti ajror | 2,010,793 | 76,300 | 0 | 76,300 | 2,087,093 |
| 04610 | Mbështetje për rrjetet e komunikacionit | 0 | 1,000 | 0 | 1,000 | 1,000 |
| 06370 | Furnizimi me ujë dhe kanalizime | 435,348 | 8,486,185 | 1,686,274 | 10,172,459 | 10,607,807 |
| 06220 | Menaxhimi i mbetjeve urbane | 180,000 | 562,042 | 475,000 | 1,037,042 | 1,217,042 |
| 04320 | Mbështetje për energjinë | 127,458 | 1,502,000 | 2,167,000 | 3,669,000 | 3,796,458 |
| 04430 | Mbështetje për burimet natyrore | 262,640 | 138,000 | 0 | 138,000 | 400,640 |
| 04440 | Mbështetje për industrinë | 267,032 | 58,000 | 0 | 58,000 | 325,032 |
| 06180 | Planifikimi Urban | 56,249 | 45,000 | 0 | 45,000 | 101,249 |

| Kodi | Emërtimi i institucionit/programit | Totali i shp. Korrente | Shpenzimet kapitale | | | Totali i shpenzimeve buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Financim i brendshëm | Financimi i huaj | Totali i shp. kapitale | |
| **10** | **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** | **57,035,839** | **4,047,329** | **668,000** | **4,715,329** | **61,751,168** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 1,181,654 | 170,500 | 240,000 | 410,500 | 1,592,154 |
| 01120 | Menaxhimi i shpenzimeve publike | 358,721 | 0 | 0 | 0 | 358,721 |
| 01130 | Ekzekutimi i pagesave të ndryshme | 771,000 | 2,480,000 | 0 | 2,480,000 | 3,251,000 |
| 01140 | Menaxhimi i të ardhurave tatimore | 2,770,499 | 625,640 | 0 | 625,640 | 3,396,139 |
| 01150 | Menaxhimi i të ardhurave doganore | 3,771,000 | 70,220 | 120,690 | 190,910 | 3,961,910 |
| 01160 | Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore | 71,675 | 2,000 | 0 | 2,000 | 73,675 |
| 04130 | Mbështetje për zhvillim ekonomik | 356,070 | 41,800 | 140,000 | 181,800 | 537,870 |
| 04160 | Mbështetje për mbikëq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr. | 289,145 | 5,500 | 0 | 5,500 | 294,645 |
| 10220 | Sigurimi shoqëror | 40,416,116 | 0 | 0 | 0 | 40,416,116 |
| 10550 | Tregu i punës | 2,108,235 | 67,000 | 0 | 67,000 | 2,175,235 |
| 04170 | Inspektimi në pune | 162,397 | 4,500 | 0 | 4,500 | 166,897 |
| 09240 | Arsimi i Mesëm (profesional) | 2,121,929 | 200,669 | 167,310 | 367,979 | 2,489,908 |
| 06190 | Strehimi | 2,657,400 | 379,500 | 0 | 379,500 | 3,036,900 |
| **11** | **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë** | **41,158,522** | **2,625,500** | **356,100** | **2,981,600** | **44,140,122** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 699,209 | 80,000 | 0 | 80,000 | 779,209 |
| 09120 | Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin) | 23,798,152 | 970,000 | 0 | 970,000 | 24,768,152 |
| 09230 | Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm) | 6,503,328 | 1,002,000 | 0 | 1,002,000 | 7,505,328 |
| 09450 | Arsimi Universitar | 9,400,000 | 236,000 | 200,000 | 436,000 | 9,836,000 |
| 09770 | Fonde për Shkencën | 315,286 | 222,500 | 156,100 | 378,600 | 693,886 |
| 08140 | Zhvillimi i Sportit dhe Rinise | 442,547 | 115,000 | 0 | 115,000 | 557,547 |
| **12** | **Ministria e Kulturës** | **2,075,191** | **1,438,500** | **160,000** | **1,598,500** | **3,673,691** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 158,390 | 0 | 0 | 0 | 158,390 |
| 08220 | Trashëgimia kulturore dhe muzetë | 609,500 | 18,000 | 65,000 | 83,000 | 692,500 |
| 08230 | Arti dhe Kultura | 1,307,301 | 1,420,500 | 95,000 | 1,515,500 | 2,822,801 |
| **13** | **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** | **71,713,147** | **1,012,444** | **1,846,645** | **2,859,089** | **74,572,236** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 447,779 | 3,000 | 0 | 3,000 | 450,779 |
| 07220 | Shërbimet e Kujdesit Parësor | 7,454,649 | 70,912 | 0 | 70,912 | 7,525,561 |
| 07330 | Shërbimet e kujdesit dytësor | 30,902,859 | 921,212 | 1,826,645 | 2,747,857 | 33,650,716 |
| 07450 | Shërbimet e shëndetit publik | 4,934,774 | 13,680 | 0 | 13,680 | 4,948,454 |
| 07460 | Shërbimi kombëtar i urgjencës | 240,159 | 0 | 0 | 0 | 240,159 |
| 10430 | Përkujdesja sociale | 26,701,602 | 3,640 | 20,000 | 23,640 | 26,725,242 |
| 01190 | Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë | 1,031,325 | 0 | 0 | 0 | 1,031,325 |
| **14** | **Ministria e Drejtësisë** | **9,345,872** | **465,700** | **0** | **465,700** | **9,811,572** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 372,699 | 86,100 | 0 | 86,100 | 458,799 |
| 03310 | Ndihma juridike | 45,700 | 1,300 | 0 | 1,300 | 47,000 |
| 01120 | Publikimet zyrtare | 43,323 | 2,000 | 0 | 2,000 | 45,323 |
| 01130 | Mjekësia ligjore | 77,650 | 5,000 | 0 | 5,000 | 82,650 |
| 03440 | Sistemi i burgjeve | 5,865,075 | 360,900 | 0 | 360,900 | 6,225,975 |
| 03350 | Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor | 126,454 | 1,600 | 0 | 1,600 | 128,054 |
| 01160 | Shërbimet për çështjet e birësimeve | 12,865 | 200 | 0 | 200 | 13,065 |
| 01180 | Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave | 2,673,620 | 5,600 | 0 | 5,600 | 2,679,220 |
| 03490 | Shërbimi i Provës | 128,486 | 3,000 | 0 | 3,000 | 131,486 |
| **15** | **Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme** | **2,581,931** | **184,500** | **80,780** | **265,280** | **2,847,211** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 238,985 | 149,500 | 0 | 149,500 | 388,485 |
| 01120 | Mbështetje diplomatike jashtë shtetit | 2,087,809 | 15,000 | 0 | 15,000 | 2,102,809 |
| 01130 | Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ-së | 184,709 | 0 | 0 | 0 | 184,709 |
| 01150 | Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrimit | 70,429 | 20,000 | 80,780 | 100,780 | 171,209 |
| **16** | **Ministria e Brendshme** | **20,141,568** | **829,800** | **683,290** | **1,513,090** | **21,654,658** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 1,177,431 | 27,250 | 0 | 27,250 | 1,204,681 |
| 03140 | Policia e Shtetit | 16,299,090 | 660,750 | 668,290 | 1,329,040 | 17,628,130 |
| 03150 | Garda e Republikës | 1,743,855 | 27,700 | 0 | 27,700 | 1,771,555 |
| 01160 | Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor | 474,014 | 84,100 | 15,000 | 99,100 | 573,114 |
| 01170 | Shërbimi i Gjendjes Civile | 447,177 | 30,000 | 0 | 30,000 | 477,177 |
| **17** | **Ministria e Mbrojtjes** | **21,325,727** | **6,299,500** | **100,000** | **6,399,500** | **27,725,227** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 1,386,356 | 36,500 | 0 | 36,500 | 1,422,856 |
| 02120 | Forcat e luftimit | 5,548,739 | 4,600,500 | 0 | 4,600,500 | 10,149,239 |
| 09430 | Arsimi ushtarak | 793,551 | 68,000 | 0 | 68,000 | 861,551 |
| 02150 | Mbështetja e luftimit | 5,749,927 | 556,000 | 0 | 556,000 | 6,305,927 |
| 07340 | Mbështetje për shëndetësinë | 1,123,930 | 250,000 | 0 | 250,000 | 1,373,930 |
| 10270 | Mbështetje sociale për ushtarakët | 5,200,000 | 0 | 0 | 0 | 5,200,000 |
| 10910 | Emergjencat civile | 1,523,225 | 788,500 | 100,000 | 888,500 | 2,411,725 |
| **18** | **Shërbimi Informativ Shtetëror** | **1,633,455** | **50,000** | **0** | **50,000** | **1,683,455** |
| 03520 | Veprimtaria Informative Shtetërore | 1,633,455 | 50,000 | 0 | 50,000 | 1,683,455 |
| **19** | **Drejtoria e Radiotelevizionit** | **567,600** | **0** | **0** | **0** | **567,600** |
| 08310 | Shërbimet për shqiptarët jashtë kufirit | 240,000 | 0 | 0 | 0 | 240,000 |
| 08520 | Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja | 197,600 | 0 | 0 | 0 | 197,600 |

| Kodi | Emërtimi i institucionit/programit | Totali i shp. Korrente | Shpenzimet kapitale: Financim i brendshëm | Shpenzimet kapitale: Financimi i huaj | Shpenzimet kapitale: Totali i shp. kapitale | Totali i shpenzimeve buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 08330 | Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare | 67,600 | 0 | 0 | 0 | 67,600 |
| 08340 | Orkestra simfonike e RTSH dhe kinematografisë | 62,400 | 0 | 0 | 0 | 62,400 |
| **20** | **Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave** | **176,995** | **83,000** | **0** | **83,000** | **259,995** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 176,995 | 83,000 | 0 | 83,000 | 259,995 |
| **22** | **Akademia e Shkencës** | **134,068** | **9,200** | **0** | **9,200** | **143,268** |
| 01520 | Veprimtaria akademike | 134,068 | 9,200 | 0 | 9,200 | 143,268 |
| **24** | **Kontrolli Larte i Shtetit** | **424,854** | **20,000** | **24,000** | **44,000** | **468,854** |
| 01120 | Veprimtaria Audituese e KLSH-së | 424,854 | 20,000 | 24,000 | 44,000 | 468,854 |
| **26** | **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** | **1,208,192** | **558,240** | **429,000** | **987,240** | **2,195,432** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 189,267 | 1,800 | 0 | 1,800 | 191,067 |
| 05320 | Programe për mbrojtjen e Mjedisit | 368,008 | 138,055 | 400,000 | 538,055 | 906,063 |
| 04260 | Administrimi i pyjeve | 317,739 | 35,100 | 0 | 35,100 | 352,839 |
| 04760 | Zhvillimi i turizmit | 333,179 | 383,285 | 29,000 | 412,285 | 745,464 |
| **28** | **Prokuroria e Përgjithshme** | **2,139,513** | **113,000** | **0** | **113,000** | **2,252,513** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 2,139,513 | 113,000 | 0 | 113,000 | 2,252,513 |
| **29** | **Këshilli i Lartë i Gjyqësor** | **3,086,656** | **385,000** | **0** | **385,000** | **3,471,656** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 258,046 | 12,500 | 0 | 12,500 | 270,546 |
| 01140 | Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë | 4,444 | 0 | 0 | 0 | 4,444 |
| 03310 | Buxheti Gjyqësor | 2,824,166 | 372,500 | 0 | 372,500 | 3,196,666 |
| **30** | **Gjykata Kushtetuese** | **146,909** | **19,000** | **0** | **19,000** | **165,909** |
| 03320 | Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese | 146,909 | 19,000 | 0 | 19,000 | 165,909 |
| **31** | **Agjencia Telegrafike Shqiptare** | **56,004** | **1,000** | **0** | **1,000** | **57,004** |
| 08320 | Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se | 56,004 | 1,000 | 0 | 1,000 | 57,004 |
| **35** | **Këshilli i Lartë i Prokurorisë** | **141,625** | **8,000** | **0** | **8,000** | **149,625** |
| 01110 | Veprimtaria e KLP-së | 141,625 | 8,000 | 0 | 8,000 | 149,625 |
| **40** | **Partitë Politike** | **356,208** | **0** | **0** | **0** | **356,208** |
| 01110 | Mbështetje për partitë politike | 345,600 | 0 | 0 | 0 | 345,600 |
| 01120 | Mbështetje për shoqatat | 8,320 | 0 | 0 | 0 | 8,320 |
| 01130 | Mbështetje për organizatat e veteranëve me status | 2,288 | 0 | 0 | 0 | 2,288 |
| **41** | **Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** | **641,971** | **21,000** | **0** | **21,000** | **662,971** |
| 03390 | Veprimtaria e SPAK-ut | 641,971 | 21,000 | 0 | 21,000 | 662,971 |
| **50** | **Instituti i Statistikës** | **541,141** | **14,500** | **172,000** | **186,500** | **727,641** |
| 01320 | Veprimtaria Statistikore | 541,141 | 14,500 | 172,000 | 186,500 | 727,641 |
| **55** | **Shkolla e Magjistraturës** | **290,468** | **8,000** | **0** | **8,000** | **298,468** |
| 09820 | Veprimtaria Arsimore | 290,468 | 8,000 | 0 | 8,000 | 298,468 |
| **56** | **Fondi i Zhvillimit Shqiptar** | **0** | **9,565,100** | **6,100,179** | **15,665,279** | **15,665,279** |
| 06210 | Programe Zhvillimi | 0 | 6,406,800 | 6,100,179 | 12,506,979 | 12,506,979 |
| 06220 | Infrastruktura Vendore dhe Rajonale | 0 | 3,058,300 | 0 | 3,058,300 | 3,058,300 |
| 04230 | Programi "100 Fshatrat" | 0 | 100,000 | 0 | 100,000 | 100,000 |
| **57** | **Qendra Kombëtare e Kinematografisë** | **156,805** | **1,000** | **15,000** | **16,000** | **172,805** |
| 08220 | Mbështetja e veprimtarisë kinematografike | 156,805 | 1,000 | 15,000 | 16,000 | 172,805 |
| **63** | **Institucionet e sistemit të drejtësisë** | **676,489** | **20,600** | **0** | **20,600** | **697,089** |
| 03320 | Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë | 151,143 | 16,000 | 0 | 16,000 | 167,143 |
| 03330 | Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit | 258,235 | 2,000 | 0 | 2,000 | 260,235 |
| 03340 | Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar | 192,576 | 2,000 | 0 | 2,000 | 194,576 |
| 03360 | Veprimtaria e Komisionerit Publik | 74,535 | 600 | 0 | 600 | 75,135 |
| **66** | **Avokati i Popullit** | **120,838** | **4,000** | **0** | **4,000** | **124,838** |
| 03320 | Shërbimi i avokatisë | 120,838 | 4,000 | 0 | 4,000 | 124,838 |
| **67** | **Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil** | **56,858** | **1,000** | **0** | **1,000** | **57,858** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 56,858 | 1,000 | 0 | 1,000 | 57,858 |
| **73** | **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** | **186,550** | **52,000** | **0** | **52,000** | **238,550** |
| 01610 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 186,550 | 52,000 | 0 | 52,000 | 238,550 |
| 01620 | Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **76** | **Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave** | **157,509** | **33,000** | **0** | **33,000** | **190,509** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 157,509 | 33,000 | 0 | 33,000 | 190,509 |
